



Viti i dhjetë i botimit, Mujore, Nr.11 (127) Nëntor 2009
 gazetamokra@yahoo.com Kryeredaktor: FLORI SLATINA
 www.poradeci.com/mokra

ÇMIMI 20 LEKE

Pogradeci me plan të ri rregullues

Plani i ri rregullues do të ketë një shtrirje kohore për 15 vjet dhe parashikon një rritje të popullsisë prej 50 mijë banorë në variantin e parë në të dytin 60 mijë e në tretin 75 mijë banorë. Varianti më i pranueshëm nga intelektualët dhe banorët është ai që paraqet një rritje të popullsisë prej 50 mijë banorësh duke krujuar më pak ndërtime dhe më shumë hapësira të gjelbërta .



Rrajca, "Mitrovica" e... Shqipërisë

Nga Selaudin BOGDANI
 Kryetar i Komunës Rrajcë

Në vazhdimësi të daljes në mediat të shkruara apo vizive për probleme madhore që ka komuniteti ynë rrajcar, të cilat për fat të keq janë bërë të padurueshme, aq sa rëndomtë përdoret shprehja: "Rrajca është kthyer në një Mitrovicë të dytë të Shqipërisë". Ju jemi drejtuar mediave për problematikën halle madhe që kemi me besim se do të jemi jo vetëm në të drejtën tonë por do të gëzojmë edhe përkrahjen për të vënë në vend atë që kërkohet: ku secili të jetojë i qetë në shtëpi të vet e në të drejtën njerëzore e ligjore garantuar nga Kushtetuta e Republikës së

Shqipërisë. Për problemin që do të trajtojmë nuk është i panjohur për instancat shtetërore, në të gjitha nivelet por që fatkeqësisht thuhet se të gjitha nuk kemi gjetur përkrahjen institucionale dhe ligjore. Kemi shkruar ankesa, kërkesa protestive deri kemi plotësuar edhe dosje të dokumenteve me të gjithë përbërësit e argumentet ligjorë në çdo instancë që përfaqëson shtetin tonë, legjislativ, ekzekutiv dhe së fundmi edhe gjyqësor por që fatkeqësisht pa pasur ende një zgjidhje institucionale.

Një shkrim i tillë kurrsesi nuk do të ishte i mjaftueshëm për të pasqyruar gjendjen aq vulgare afero-korruptive në problematikën absurde të cënimit të integritetit të Komunës Rrajcë dhe ndofta do të duheshin edhe shumë volume

Çezma në shekujt XX -XXI

Zalo Musa PALLA

Në jug-perëndim të Mokrës së Sipërme në një teritor paksa të veçantë janë vendosur ngulimet e katër fsha-

trave: Çezma e Vogël, Çezma e Madhe, Hondishti dhe Llënga. Këto vendbanime janë vendosur në një ngritje tektonike me lartësi më të madhe 1358 m. mbi ni

Librazhdi në rrjedhën e historisë

Nga Zabit ÇUKU



JETA 6-MUJORE E GJERASIM D. QIRIAZIT ME KAÇAKËT

Nga Zenun FERRO

Gjerasim Qiriazhi, ka përshkruar jetën e cubave, bisedat e tyre dhe të gjitha ato që i kanë ndodhur nga 12 nëntor 1884 deri 25 prill 1885, gjashtë muaj sa ka qënë pengu i tyre. Dorëshkrimin e la në gjuhën shqipe, por nuk është gje-



(In Memoriam - Guri Tola)

Kur largohet një mik i dashur

Kreu i Bashkisë, Artan Shkëmbi: Pogradeci me plan të ri rregullues

Plani i vetëm rregullues për qytetin e Pogradecit është miratuar në vitin 1983. Që nga ky vit nuk është ndërmarrë më ndonjë nismë për të paraqitur ndryshimet e bëra në vitet e kthesës. Qyteti është zhvilluar me plan "shkatërues". Ndërto ku të mundesh e si të mundesh. Nevoja për të pasur qyteti liqenor, me liqenin më të vjetër në Ballkan, një plan të ri rregullues është ndier prej kohësh.

Pergatitjet

Kryetari i Bashkisë së Pogradecit Artan Shkëmbi, që ndjek dhe fazat e përgatitjes së planit të ri rregullues, u shpreh për gazetën "Telegraf", se "Kemi bërë dy takime, ku kemi paraqitur tre variante të mundshme për planin rregullues të qytetit që i ka munguar prej kohësh. Një takim e kemi zhvilluar me grupet e interesit dhe një tjetër me intelektualët dhe banorë të qytetit për të parë dhe të shprehur mendime rreth projekteve të paraqitura nga instituti i Projektimit". Shkëmbi gjithashtu bën me dije se Plani i Rregullues do të marrë miratimin në Këshillin Bashkiak dhe në KRT-në e Bashkisë dhe pasi ta kemi kompletuar e të kemi zgjidhur variantin më të mundshëm do ta paraqesim në KRT-në e Republikës për t'u vënë në zbatim. Grupi i studimit e ka nisur punën që në vitin 2003 dhe gjatë kësaj

Plani i ri rregullues do të ketë një shtrirje kohore për 15 vjet dhe parashikon një rritje të popullsisë prej 50 mijë banorë në variantin e parë në të dytin 60 mijë e në tretin 75 mijë banorë.

kohe ka hedhur të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur.

Lidhur me shqetësimin se ndërtime aktuale kanë arritur në 9-dhe 10 kate, z. Shkëmbi tha: "Nuk mbetet pa u parashikuar dhe lëvizja ujore dhe krijimi i një moli për sistemimin e varakve. Zona e kalasë ruan vlerat të pa ndryshuara dhe të pa prekshme për vetë vlerat që ajo mban për qytetin duke krujar rreth saj një park e nuk do të lejohen të bëhen ndërtime. Parku i qytetit do të ngrihet rreth kalsaë. Kërkesë shtesë për t'u parë në planin rregullues nga diskutimet doli dhe mundësia e krijimit të një distrikti për artistët.



Ndryshime do të ketë rruga nacionale që sot kalon përmes qytetit. Ajo do të ketë devijim dhe do të eliminojë zhurmat dhe do të lehtësojë trafikun brenda qytetit. Ajo që bie në sy duke parë skicat e planit rregullues është krijimi i parqeve dhe zonave turistike. Parashikohet një zgjerim i sipërfaqeve të banuara nga 200 hektarë aktualisht në 615 hektarë. Zona sportive do të zerë 6.36 hektarë. Zona ekonomike 18.63 hektarë. E pandryshuar do të mbetet edhe për 15 vjet rezidenca Qeveritare me një sipërfaqe

aktuale 3.72 hektare. Por rritja në lartësi do të lejohet deri në tetë katë.

Plani i ri rregullues do të ketë një shtrirje kohore për 15 vjet dhe parashikon një rritje të popullsisë prej 50 mijë banorë në variantin e parë në të dytin 60 mijë e në tretin 75 mijë banorë. Varianti me i pranueshëm nga intelektualët dhe banorët është ai që paraqet një rritje të popullsisë prej 50 mijë banorësh duke krujar më pak ndërtime dhe më shumë hapësira të gjelbërta.

Pëllumb ÇUNI

BETEJA E DOMOSDOVËS DHE LUFTA E POJSKËS PJESË E PROGRAMIT TË KURSIT TË LARTË TË OFOCERIT TË AKADEMISË MBROJTEJES

Nga N/kolonel Kasem SALIASI

Më 23-24 tetor 2009 Akademi i Oficerit, zhvillojnë një udhëtim studimor në Mushqeta, Domosdovë, e Pojskë nën drejtimin e pedagogëve të Departamentit të Strategjisë dhe Historisë, nënkolonel Blenard Zotaj, zotit Muharrem Alba. Ishte një udhëtim sa tepër histori aq edhe nëpër shpirtin e popullit shqiptar.

Beteja e Mushqetasë është quajtur pagëzimi i fitores drejt çlirimit të Tiranës 17 nëntor 1944. Për këtë betejë folën akademikët nënkolonel Dashnor Beta, nënkolonel Fredi Dino e nënkolonel Viktor Pershqefa.

Ndajlesia e dytë ishte në Domosdovë, atje mëse pesë shekuj më parë, më 29 qershor 1444, Gjergj Kastrioti Skënderbeu zhvilloi një nga betejat më të lavdishme dhe në kuroizim të tij bëteja e Torviollit. Edhe pse me forca të pakta, pothuajse sa gjysma e numurit të trupave të ushtrisë turke të drejtuara nga komandanti më i besuar sulltan Muratit të II, Ali Pasha. Por Skënderbeu duke njohur mirë terrenin, duke përdorur në mënyrë efikase maskimin nëpërmjet realizimit me finesë prej strategu të tërheqjes së përkohshme, arriti të bëjë një rrethim të plotë të forcave kryesore osmane dhe i shpartalloi ato në një kohë record. Dhe jo pak por 25000



trupa prej të cilëve 15000 ishin kalorës. Pas një sërë fitoresh të njëpasnjëshme në Evropë kjo ishte disfata e parë e ushtrisë turke. Kjo betejë e bëri të njohur Gjergj Kastriotin në kancelaritë e Evropës dhe shumë shpejt Papa do ta pagëzonte "Atletin e Krishtëritit".

Këtë fitore në planin e brendshëm Skënderbeu do ta shfytëzonte për bashkimin e principatave shqiptare rreth vetes, të cilët panë tek ai mendimtarin dhe starvegun e duhur dhe korrekt. Skënderbeu

do të kryente në ardhmen edhe fitore të tjera, por fitorja e arritur në betejën e Torviollit, siç theksonte Fan.S. Noli ishte fitorja e njëres prej betejave më të shkëlqyera të zhvilluara prej tij, si nga ana taktike ashtu edhe për objektin e saj startegjik.

Pas kësaj, udhëtimi ynë i përbashkët, një udhëtim pune dhe argëtimi njëkohësisht u nis drejt Pogradecit duke shijuar pejsazhe të mahnitshme të natyrës turistike shqiptare. Në Pogradec do të shpalosej jo vetëm bukuria natyrore, por edhe

historia. Pas një dreke pune buzë liqenit të Ohrit u drejtua drejt Pojskës. Pikërisht, aty ku u zhvillua beteja e përgjakshme e drejtuar nga Heroi i Popullit Reshit Çollaku. Ishte nga betejat më të lavdishme, por edhe më të kushtueshme po t'ju referohemi humbjeve. Terreni i zgjedhur nuk ishte i përshtatshëm. Opsioni i komandës së luftëtarëve shqiptarë për një tërheqje të shpejtë pas goditjes së parë drejt maleve të Mokrës nuk u realizua dot. Megjithatë, qëndresa heroike e batalionit partizan të asja kohe të drejtuar nga Reshit Çollaku u kthye në një simbol të heroizmit, të qëndresës, të shpirtit të sakrificës dhe të patriotizmit antifashit për shqiptarët.

Forcat antifashiste në këtë betejë, treguan veten si një detashment i organizuar dhe në radhë të parë, me një disiplinë të qartë e të vendosur, për të dhënë edhe jetën për arritjen e objektivit.

Kjo betejë do të ishte kushtimi i parë dhe të rënë e saj ishin nga dëshmorët e parë të një ushtrie çlirimtare tanimë në rrugën e betejave të mëdha ballorë me armikun. Ky tripik: Mushqeta-Torvioll-Pojskë, na mësoi edhe një herë në udhëtimin tonë tre fletë të lavdishme të historisë së Shqipërisë, të luftës për liri. Njëkohësisht ato ishin tre leksione në natyrë dhe të paharrueshme për kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit të realizuar me aq kujdesa nga Departamenti i Strategjisë dhe Historisë në Akademinë e Mbrojtjes.

Rrajca, "Mitrovica" e... Shqipërisë

Nga Selaudin BOGDANI

Kryetar i Komunës Rrajcë

Në vazhdimësi të daljes në mediat të shkruara apo vizive për probleme madhore që ka komuniteti ynë rrajcar, të cilat për fat të keq janë bërë të padurueshme, aq sa rëndomtë përdoret shprehja: "Rrajca është kthyer në një Mitrovicë të dytë të Shqipërisë". Ju jemi drejtuar mediave për problematikën hallemadhe që kemi me besim se do të jemi jo vetëm në të drejtën tonë por do të gëzojmë edhe përkrahjen për të vënë në vend atë që kërkohet: ku secili të jetojë i qetë në shtëpi të vet e në të drejtën njerëzore e ligjore garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Për problemin që do të trajtojmë nuk është i panjohur për instancat shtetërore, në të gjitha nivelet por që fatkeqësisht thuajse te të gjitha nuk kemi gjetur përkrahjen institucionale dhe ligjore. Kemi shkruar ankesa, kërkesa protestive deri kemi plotësuar edhe dosje të dokumenteve me të gjithë përbërësit e argumentet ligjorë në çdo instancë që përfaqëson shtetin tonë, legjislativ, ekzekutiv dhe së fundmi edhe gjyqësor por që fatkeqësisht pa pasur ende një zgjidhje institucionale.

Një shkrim i tillë kurrsesi nuk do të ishte i mjaftueshëm për të pasqyruar gjendjen aq vulgare afero-korrutive në problematikën absurde të cënimit të integritetit të Komunës Rrajcë dhe ndofta do të duheshin edhe shumë volume të tjera. Të qartë, të bindur dhe të vendosur në të drejtën tonë kushtetuese me përkushtimi absolutisht maksimal do të shkojmë çështjes deri në fund për të mbrojtur me çdo kosto çdo metër katrorë tokë rrajcare nga hajdutët e të gjitha llojeve me synimin e vetëm që të çojmë në vend dinjitetin e nëpërkëmbur nëpër vite nga bastardët e çdo kallëpi.

Komunitetit rrajcar fatkeqësisht i janë rrëmbyer troje të tëra në vazhdimësi dhe mbetet një nga subjektet administrative të pushtetit lokal me më pak tokë për frymë. Që në vitin 1913 me caktimin e kufijve shtetërorë me Maqedoninë, shumë toka rrajcare mbetën jashtë kufirit. Fat është se edhe mbi fshatin Ladorisht, Komuna e Strugës një pllajë e tërë quhet edhe sot "Gështenjat e Bogdanëve të Rrajcës".

Uraka si pasardhëse e Orakullit, treguesi i profetësisë të shekullit të II, vendlindja e dëshmorëve këshilltarë, sot banorët e saj nuk njihen si pronarë të ligjshëm të tokës së tyre, i vetmi rast ky, unikal për gjithë Qarkun e Elbasanit. Fshati Katjel, historikisht pronar i fushës së Pojskës, me emërtimin e vërtetë "fusha e Katjelit", i mohohet e drejta e pronësisë. Ndërkohë që vetëm traseja e hekurudhës u ka marrë rrajcarëve mbi 40 ha tokë bujqësore. Liqene në qendër të komunitetit ka zënë bashkë me digën rreth 25 ha tokë. Rruga automobilistike nacionale mes përmes komunës sonë i ka marrë këtij komuniteti 13 ha tokë.

Për të vazhduar më pas me çudinë më antikushtetuese që mund të ketë

bërë vaki ndonjëherë. Kjo tek tokat historikisht rrajcare në doganën e Qafë-Thanës, ku për arsye që kuptohet vetë, kanë mbetur shtetërore. Dhe jo pak por mbi 15 ha tokë, ku edhe aktualisht për hir të së vërtetës i gëzojnë rrajcarët por që nuk u njihet për asnjë arsye tapitë dhe ca më pak që ti certifikojnë. Por ky problem do të ketë një trajtim të veçantë në shkrimet e mëvonshme sepse në plan të parë del abuziviteti dhe absurditeti më i pashprehur që qëndron në mënyrën më absolute në pretendimet bastardike të bashkiakëve të Përrenjasit ndaj territoreve të komunitetit rrajcar, duke synuar me metoda majoze korrutive të çenojë integritetin territorial të Komunës Rrajcë.

Fillimisht Komuna Rrajcë dhe Bashkia Prrenjas ishin një njësi administrative, Komuna Përrenjas me epiqendër qytetin me 9 fshatra me popullsi prej 20 mijë banorësh, si njësi amalgane ku prioritet natyrisht kishte qyteti ndërsa fshati ngrohej në diell si qëmoti. Ndaj u kërkuar me forcë ndarja, e cila u realizua më 1996. Ndarja administrative është bërë me VKM nr 269 datë 25.06.1992, ndryshuar me VKM nr 852 datë 12.08.1996 dhe me ligjin nr 8658 datë 31.07.2000. Në bazë të këtyre dispozitave veçse ligjore përcaktohet qartazi si drita e diellit se:

1) Bashkia/Komuna Përrenjas e përbërë nga qyteti Përrenjas me fshatrat Përrenjas-fshat dhe Rashtan.

2) Komuna Rrajcë me qendër Rrajcë e përbërë nga fshatrat, Rrajcë-Fushë, Sutaj, Skënderbe, Bardhaj, Katjel, Urakë dhe Kotodesh.

Theksojmë se pavarësisht ndarjes administrative-tokësore në vitin 1996 sipas përkatesive të mësipërme, fshati Rrajcë i emërtuar në vitin 2000 edhe si Rrajcë-fushë ka ekzistuar që në lashtësi dhe historikisht me një popullsi autoktone e pa përzier asnjëherë dhe me territor të caktuar dhe kufij të saktë.

Ndërmjet fshatit Rrajcë dhe fshatit Përrenjas nuk ka pasur asnjëherë marrëveshje për sa i përket kufijve të tyre territorialë pasi këto kanë qenë të saktësuar me dokumente arkivore. Përmendim këtu "Letër-kufinj" e vitit 992 sipas kalendarit islam në të cilin kufiri territorial i fshatit Rrajcë përcaktohet shumë qartë dhe me emra vendesh të njohur. Gjithmonë mbi bazën e këtij dokumenti kufiri i fshatit Rrajcë kalon poshtë ish-PAM (parkut të makinave), kthehet drejt veriut duke përkrahur një pjesë të qytetit deri në arën e Ded Kolës, që sot është spitali i qytetit Përrenjas. Duke vazhduar më pas më tej drejt deri tek sheshi i Dukës, i njohur si kreu i sheshit.

Ky është dokument me vlerë ligjore që tregon qartazi të vërtetën madhore për pronat rrajcare që mundohen t'i grabisin bastardët. Shumë e qartë dhe e saktë kjo ndarje mes fshatit Rrajcë dhe atij Përrenjas ka qenë edhe në kohën e mëvonshme të monarkisë së mbretit Zog e më pas.

Nisur nga fakti se ligji nr 108: Reforma agrare shpronësoi fshatarët të Rrajcës përsëri shtrirja territoriale e Rrajcës dhe ajo kufizuese me Përrenjasin ka qenë saktësisht e përcaktuar në kohët e mëvonshme deri në ditët tona. Me fillimin



e demokracisë, viti 1991 në bazë të ligjit nr 7501 për tokën kemi saktësisht ruajtjen e shtrirjes territoriale dhe kufijve autoktonë të Rrajcës. Banorët e këtij fshati përfituan tokë sipas ligjit në fjalë, por faktikisht në pronësi ata morën tokën që kanë pasur në pronësi të parët e tyre.

Me vendimin nr 7 datë 17.09.1991 të Komisionit të ndarjes së tokës të këshillit të rrethit Librazhd janë përcaktuar kufij të fshatit Rrajcë dhe Përrenjasit të shprehura në plashetën nr 194-D të ZK (zonës kadastrale) 3203 Rrajcë-Fushë. Shumë qartazi, e dukshme, e prekshme (vetëm po nuk deshe) kufiri ndarës mes Rrajcës dhe Përrenjasit është: Duke filluar nga ish-PAM drejt rrugës nacionale në perëndim të karburantit ELDA, ecën drejt tek ish-tunelet e ushtrisë dhe vijon gjatë luginës duke arritur në majë të kodrës dhe kthehet në drejtim të perëndimit deri tek sheshi i Dukës. Mbi këtë vendbanim bazë banorët e Rrajcës gëzuan taksativisht të drejtën e pajisjes me tokë bujqësore, dhe jo pak por për rreth 210 familje që zotërojnë në regjistruara në ZRPP-në e Librazhdit dhe pikërisht këto toka kufizohen me bashkinë Përrenjas.

Pretendimet e bashkisë Përrenjas mbi këtë territor janë sofizma naivo-injorantësh, shumë të djallëzuara dhe të mpleksuara në afera hajdutërie dhe korrutive të ishëve dhe aktualëve. A mund të quhet argument apo fakt juridik pse lagjja "Balla" ku disa familje kanë bërë pasaportizimin në Përrenjas dhe vallha këtu na qenka kufiri mes Komunës dhe Bashkisë? Këta hileqarë dhe qëllimdashakeqës harrojnë se e ashtuquajtura lagjja "Balla" (se mund të quhej dhe Laçka ose Hallidri) është historikisht dhe aktualisht tokë rrajcare dhe pjesë e kadastrës 3203. Realisht këto pak familje nuk janë autoktone por të ardhura nga Uraka deh kategorikisht nuk mund të bëhen shkak kurrsesi për ndryshim të vijës kufizuese mes Rrajcës dhe Përrenjasit.

Në këtë territor kanë banesat e tyre dhe tokën në pronësi mbi 50 familje rrajcare autoktone të regjistruara në Komunën Rrajcë dhe të gjitha këto familje (përfshi këtu edhe fisin Balla) kanë tokat në pronësi të zonës kadastrale 3203 duke theksuar sërish se vija kufizuese është e përcaktuar qartë historikisht deri në ditët e sotme. Çudia e këtyre makabriteteve qëndron në një fakt të hidhur se paria e qytetit Përrenjas, si kryebashkiakë vijnë kokoshë nga stepat e malësisë së Llangës së Pogradecit apo të Gorës dhe Oparit, të sëmurë këncerozë që mundohen të nxisin urretje fëlliqësirë në mënyrë të miqësive që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë mes popullit të Përrenjasit dhe atij të Rrajcës.

Qartësojmë më tutje se:

a) Në kufij me qytetin Përrenjas, rrajcarët kanë ndërtuar shtëpi me leje ndërtimi nga Komuna Rrajcë si i vetmi organ që mund të japë vendime dhe të ushtrojë kompetencat e veta në këtë territor në administrim.

b) Trashëgimia historike e kufirit natyror, administrativ mes Rrajcës dhe

Përrenjasit fshat.

c) Lidhja organike e tokave bujqësore të fshatit Rrajcë-fushë me gjithë pjesën veriore të faqes së kodrës mbi rezervuar, sot Rrajca e re.

d) Banorë 100% rrajcarë në lagjen "Rrajca e re" homogjenë dhe nuk ka asnjë banor të ardhur nga Përrenjas ose gjetkë.

e) Pronësia e tokës e vërtetuar nga ZRPP-ja Librazhd me dokumente (certifikatë pronësie) është po e këtyre banorëve

f) Banorët e kësaj lagjeje janë zgjedhës të Komunës Rrajcë, të cilët kanë votuar rregullisht në këtë komunë.

g) Aktiviteti ekonomik i kësaj lagjeje është përshtatur me drejtimin blektoralo-bujqësor dhe vetë urbanizimi po ashtu.

h) Administrata e komunës është vendosur e baraslarguar nga fshatrat për ti shërbyer sa më mirë banorëve të këtij komuniteti. Jo pak por janë 88 familje rrajcare të shpronësuara nga kufiri me Përrenjasin deri tek dogana e Qaf-Thanës me sipërfaqe 1.7 ha të rrugës nacionale, rikonstruktuar nga shteti në vitin 2002.

Pra kjo tregon edhe një herë se vetë shteti disponon dokumente ligjorë për tokën taksativisht dhe e respekton atë kushtetueshmërisht. Në qoftë se Rrajca ka dokumente ligjorë-historikë që argumenton katërçipërisht autoktoninë e vet, liliputët e bashkisë Përrenjas ngrenë alibi, e veprojnë në mënyrë më mafiozet duke pretenduar me sofizma të tilla si: "I thonë Përrenjas (duke i vënë vetë emërtimet), ose këtu apo aty ka kullotur kalin Dylli dhe se kemi banorë që kanë pasaportizimin në Përrenjas, se në territorin e Rrajcës ka ndërmarrje shtetërore dhe i përkasin vetëm Përrenjasit, se këto toka janë periferi e qytetit, etj, etj.

Kamelleonët e bashkisë Përrenjas si paraardhësit dhe aktualët kanë të njëjtën fytyrë të stonuar, vetëm me synimin për të shkatërruar Rrajcën bashkë me kulturën e saj madhore, që ka përfaqësuar denjësisht edhe kombin, madje edhe ndërkombëtarisht. Me ndarjen e komunës Përrenjas në vitin 1996 duke përfituar nga mefshhtësia e komunarëve të Komunës Rrajcë "maçokët" e bashkisë Përrenjas mjaullijnë njëri pas tjetrit deri sot për ti rrëmbyer rrajcarëve edhe atë pak tokë që u ka mbetur, madje për ti larguar nga trojet duke i nënshtruar egërsisht. Janë munduar dhe kanë penetruar fatkeqësisht edhe tek përfaqësues të shtetit dhe instanca shtetërore për të arritur qëllimet e tyre korrutive për grabitjen e territoreve të Rrajcës.

Mekanimizant antiligjorë-djallëzorë të kryebashkiakëve të Përrenjasit, njëri më intrigant se tjetri, në vazhdimësi kanë synuar tinzarisht të rrëmbejnë trojet rrajcare deri agresivisht që përbën në vetvete një cënim të integritetit territorial të një populli. Në vitin 1994-1995 në komunën e Përrenjasit u paraqit një studim urbanistik nga këshilli i rrethit Librazhd dhe vetë këshilli i komunës i asaj kohe vendosi që pjesën kadastrale 3203 të ndërtonin vetëm rrajcarët, realisht në pronat e tyre. Vendimi nr 8 datë 25.09.1998 i KRRT të rrethit, që është totalisht i paligjshëm dhe në kundërsht të cilido ligjitë dhe udhëzimit të dalë më parë dhe më pas për Rrajcën dhe Përrenjasin, kurrsesi nuk mund të shërbejë si argument për të prekura dhe ca më pak për të rrëmbyer territoret e komunës Rrajcë. Duhet të jesh vërtet injorant, djallëzor, i korruptuar në çdo qelizë që KRRT-të ti paraqitësh si instancë për ndarjen territoriale administrative të subjekteve të pushtetit vendor dhe jo si "ndërtuese urbanistike", qëllimi i vetëm për të cilin janë ndërtuar.

Pellumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"

Zenun FERRO, nënkryetar i shoqatës

Zabit Çuku, sekretar i shoqatës

Dega e Pogradecit: Kryetar Llazi TONA

Kryeredaktor Flori SLATINA

www.poradeci.com/mokra gazetamokra@yahoo.com

florislatina@yahoo.com

Çezma në shekujt XX - XXI

Zalo Musa PALLA

Në jug-perëndim të Mokrës së Sipërme në një teritor paksa të veçantë janë vendosur ngulimet e katër fshatrave: Çezma e Vogël, Çezma e Madhe, Hondishiti dhe Llënga. Këto vend-banime janë vendosur në një ngritje tektonike me lartësi më të madhe 1358 m. mbi nivelin e detit tek Ahishta e Çezmës, 1238 m. tek korja e hezmës dhe 1107 m. tek (brigjet) kodra e Çezmës me toponim Bregu i Veselit, fshati shtrihet (Çezma e Vogël) nga lartësia rreth 1015 që vjen duke u ulur.

Interesant është fakti që "topografët" e lashtësisë kanë piketuar e vendosur ngulimet e qendrave të banuara pothuaj me lartësi të barabartë. Psh. duke krahasuar Kalivaçin-Rruga automobilistike është 1010 m. lartësi kurse Çezma e Vogël 1015 m. pra me një diferencë prej disa metrash dhe kjo është e pranueshme po të kemi parasysh "Instrumentat" e natyrës që kanë përdorur dhe që janë të pranishme edhe në ditët tona, siç janë kurora e mjergullës dhe ajo e dëborës që në kohë të ndryshme presin breza të lartësive të ndryshme dhe luhajte të temperaturës.

Kjo ngritje tektonike ku janë vendosur këto katër fshatra të lë përshtypjen e një gadishulli të vogël në trevën e Mokrës së Sipërme për faktin se ajo është e rrethuar nga një kordom i bardhë i burimeve të Shkumbinit, nga lindja burime që vinë nga Kalivaçi e Dhenica nga Jug-Perëndimi nga burimet e Llëngës, ujtit të ftohtë e Bishnicës të cilat bashkohen në Rspendje (rëra e Slabinjës) dhe lidhet me tokë vetëm me 1/3 në jug-lindje të saj, këtu qëndron edhe e veçanta e kësaj pjesë të Mokrës së Sipërme.

Nga Lindja në vendin ku takohet përroj i Çezmës me lumin shënon nivelin 647 m. lartësi, pra është më ulët nga niveli i liqenit të Ohrit që ndodhet 695 m. mbi nivelin e detit, 48 m. më ulët, kurse veri-perëndim ku bashkohet Shkumbini me Lumin e Bishnicës është më lartësinë 884 m. lartësi, 189 m. mbi nivelin e liqenit.

Në këtë gadishull të vogël, në qoftë se mund ta quajmë kështu ka shumë toponime të vjetra ashtu si edhe shumë histori e legjenda e ngjarje që për shumë arsye, objektive e subjektive është e pamundur t'u jepet përgjigje.

Toponimi i vjetër dhe origjinal i Çezmës ka qenë kroj i madh, për Çezmën e madhe dhe kroj i vogël për Çezmën e vogël dhe kjo për arsye dhe sipas burimeve të ujit që kanë pasur këto dy fshatra, sipas gjasave këto toponime kanë qenë para pushtimit të vendit nga perandoria turke, në atë periudhë, kur këto vendbanime ishin të krishtera dhe objektet e kultit ishin vetëm Kisha, të cilat përmenden edhe sot për të dy fshatrat.

Në qendër të Çezmës së Vogël, në mes të lagjes është edhe



sot një shesh i vogël që mban emrin kishë, këtu ka edhe shumë gjurmë të mbetjeve të asaj periudhe, aty rreth viteve 1954-55 kemi gërmuar për të nxjerrë gurë dhe janë zbuluar themelet e kishës rreth 1.5 m. të gjëra, kemi gjetur edhe një copë të suvatuar dhe me figura gjeometrike me bojra që s'kishin ndërhyrë tek njëra tjetra, gjithashtu janë gjetur edhe skelete varresh dhe një varr me 4 kate. Çezma e vogël ka qenë si qendër për këto katër fshatra, në këtë shesh mblidheshin burrat e katër fshatrave për të diskutuar probleme të ndryshme e të përbashkëta, rreth 200 m. më veri të kishës ka qenë ndërtuar një xhami, që ishte me gjysëm minare, nuk e di në ishte shembur apo nuk ishte mbaruar së ndërtuari edhe këtu ishte një shesh, quhej sheshi i xhamisë që ishte gjithashtu edhe varrezë e vjetër. Xhamia me siguri që është ndërtuar mbas pushtimit të vendit nga perandoria osmane, kohë në të cilën duhet të ketë ndodhur edhe një katastrofë e madhe duke shkatërruar të gjitha kultet e mëparshme të krishtera dhe kulturën ekzistuese duke sjellë edhe ndryshimet demografike të mëparme.

Kësaj periudhe i përket edhe ndryshimi i toponimeve për të dy fshatrat. Fjala Çezma është me prejardhje nga turqishtja. Çesme, tani, sikur s'është zëvendësuar z dhe kush ka qenë arsyeja unë nuk di ta them, është për arsye të dialektit të zonës apo ndonjë tjetër, këto janë probleme të leksikologjisë, por sido që të jetë origjina mbetet e pandryshuar, kroj i vogël - Çesma e vogël - Çezma e vogël.

Rreth viteve 34 të shekullit të kaluar, në kohën e Zogut është bërë një përçapje për të vendosur toponimet shqip të mëparshme për t'u kthyer te kroj i madh dhe kroj i vogël, por kjo nuk ka funksionuar e ka mbetur vetëm në letër.

Toponimi i vjetër dhe origjinal i Çezmës ka qenë kroj i madh, për Çezmën e madhe dhe kroj i vogël për Çezmën e vogël dhe kjo për arsye dhe sipas burimeve të ujit që kanë pasur këto dy fshatra, sipas gjasave këto toponime kanë qenë para pushtimit të vendit nga perandoria turke, në atë periudhë, kur këto vendbanime ishin të krishtera dhe objektet e kultit ishin vetëm Kisha, të cilat përmenden edhe sot për të dy fshatrat.

II

Arterjet që lidhin këto vendbanime me pjeët edhe vendbanimet e tjera të Mokrës dhe të trevave të tjera përreth janë të shumta, por më kryesoret janë rruga që vjen nga perëndimi që kalon në Llëngë (Llënga, nga shqipja e vjetër, do të thotë grykë lumi, luginë), rrugë që kalonte nëpërmjet dy urave të gurta, njëra të gryka e gurit dhe tjetra që ekziston edhe sot gjysma e rrënuar, pastaj kur shkon për nga ujët e ftohtë.

Rruga tjetër lidhëse vjen nga Slabinja e Losniku dhe kalonte nëpër Hondishit dhe kjo arterie ka patur një urë të gurtë tek vendi me toponim - Mulliri i Kolanxhit dhe e treta rruga që vjen nga zona lindore (Trebinjë-Pervelan) edhe në këtë arterie duket edhe në ditët tona një urë e gurtë që ndodhet rreth 200 m. nën rrugën automobilistike të soçme, tek përroj i çezmës. Këto rrugë kanë qenë ndërtuar me kalldrëme dhe sipas gjasave kanë qenë degëzime të rrugës Egnatia ku lëviznin karvanet e kuajve të cilët kanë lënë të gdhendur në gur gjurmët dhe mundin e tyre.

Skalitja me gur i këtyre gjurmëve dëshmon për lashtësinë e këtyre trevave dhe është e lidhur me periudhën e hekurit ku një nga prodhimet e para që solli të

ardhura e fitime për farkëtarët ishte patkoj që gjeti treg të bollshëm tek karvanët që deri atëhere kishin lëvizur të zbathur. Këtej e ka prejardhjen simboli i patkojt që edhe sot vendoset në banesa dhe objekte të shumta për të sjellë fat ashtu siç u solli hekurpunuesve të parë.

Gjurmët e skalitura në gur nga këmbët e mbathura të karvanëve janë të shumta, të qarta e të pa vdekshme, si në shullenjtë e Llëngës, tek varri Serjanit, Kardhëket e Malinës, Rrasa e Çezmës e shumë vende të tjera që është apo mundur të përmenden, në gjithë se gjurma të tilla ka në çdo trevë në arterjet kryesore.

Arterja lindore e Çezmës lidhet me një toponim (emër) të njohur për të gjithë zonën e Mokrës dhe mbase më gjërë dhe kjo për shkak të përpjetës së madhe që ka - *Kamniku*.

Në shqipen e vjetër kanik do të thotë - vendqëndrimi, vendpushimi, por sesi ndryshoj emri duke shtuar gërmën m, dhe nga Kanik u bë Kamnik, për arsye dialekti apo leksikore është tjetër punë por prejardhja e toponimit është kjo e sotmja.

Kamniku ka qenë një gur i madh ose një shkëmb i vogël në krye të përpjetës me të njëjtin emër dhe rrëzë këtij shkëmbi

pushonin udhëtarët për t'u çlodhur, me kalimin e kohës ky shkëmb u shemb dhe gërmadhat e gurëve ndodhen dhe duken edhe sot në postena tek mulliri i Kadriut, ai u zhduk por toponimi mbeti dhe vendi edhe në ditët tona përdoret si vendqëndrimi e çlodhje (si stacion) në mes të përpjetës. Kamniku ndodhet në lartësinë rreth 710 m. mbi nivelin zero.

Në Kamnik tek rrasa ku ndan rruga për në Çezmën e vogël, në të djathtë kur shkon përpjetë, në një pjesë toke (trekëndëshe) janë gjetur edhe gjurmët e një punishteje guri ku gdhendeshin gurë e kallama guri për ndërtimin e objekteve të kultit dhe një pjesë e një kollone guri të tillë është e oranishme edhe në ditët tona si dëshmi e asaj periudhe por sidoqoftë këto janë objekt i gjeologjisë, mbase në një të ardhme do të dalin në dritë shumë dëshmi deri tani të mbetura në errësirë apo të arshivuara nga natyra.

Në këtë pjesë të territorit të Mokrës, në lartësinë rreth 900 m. mbi nivelin e detit ndodhet manastiri i Shën Marinës i cili ka një histori më vehte. Këtu më 18 korrik të çdo viti mblidheshin për të festuar popullsi me përkatësi të ndryshme fetare dhe jo vetëm nga Mokra, por edhe Gramshi, Elbasani e më gjërë, ky fakt tregon edhe bashkëjetesën në paqe e harmoni të popullit tonë.

Në këtë pjesë, në jug-lindje të Shmerenës, në lartësinë 975 m. janë ndërtuar dy rezervuarë, vepra ujitëse për vaditje të zonës së Mokrës deri në Trebinjë e Pleshisht. Këta rezervuarë janë ndërtuar në vendin me toponim Mujaze që vjen nga emri rejaze kështu quhej ajo luginë me një bukuri të rrallë në këtë lartësi mbasi vetë luginë në pjesën më të madhe të saj rrinte gjithmonë e lagësht si një sfungjer i ngopur me ujë dhe mblidhte ujrë që





rridhnin nga të dy krahët e saj. Periudha e dimrit shtonte rrjedhat e ujit dhe lugina krijonte në shtratin e saj një përrua që humbiste në fund të luginës dhe dilte në Shkumbin, kjo për faktin se lugina ishte e mbyllur dhe lartësohej tek kryqi i Shën-Marenës dhe për këtë arsye vendi edhe sot mban toponimin "ku humbet ujët" që sot është një gropë natyrore në fund të digës së rezervuarit.

Kurse kryqi i vjetër ka qenë vendosur më lart, në veri të kryqit ekzistues, tek guri i shpuar që është i pranishëm edhe në ditët tona.

Në luginën e rejazes, aty ku dilte rruga që rrinte nga Llënga ka qenë një burim uji me emër (toponim) Poçe, quhej kështu nga fakti i ndërtimit të saj, ishte ndërtuar në formën e një pusi të vogël me mur guri rreth 0,5 m. të thellë, kjo për ujin e ftohtë që kishte ishte bërë një vend pushimi e qëndrimi për udhëtarët që kalonin dhe banorët e zonës.

Këtu, te Poçja ka qenë edhe lapidari i ngritur në përkujtim 31 martirëve të pushkatuar nga Llënga në masakrën e këtij fshati nga nazifashizmi dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas në vitin 1942 dhe që mbas ndërtimit të rezervuarëve ka ndërruar vendin.

I përmenda këto për faktin se Poçja nuk ekziston më ajo baskë me ujin e ftohtë që kishte, është varrosur në fund të rezervuarit. Po kështu edhe lapidari si dëshmi të së kaluarës nuk ndodhet më në vendin e ngjarjes makabre të asaj periudhe që shkaktoj aq dhimbje që do të mbetet gjatë në kujtesën e banorëve të zonës.

Lapidari sot ndodhet diku aty rrotull vendit të ngjarjes pas rrugës që shkon për në fshatin Llëngë. Në këtë pjesë të Mokres së sipërme ka një florë dhe faunë të pasur në ujrat e Shkumbinit rriten korani e Belushka si dhe një gjitar i rrallë, Vidra ose Lundra që ushqehet kryesisht me peshk dhe shumimin dhe këlyshët i bën në tokë. Këtu gjenden edhe kaprolli, derri i egër, macja e egër, kunadhja, gjeli i egër dhe shumë kafshë e shpezë të tjera që janë të pranishme në të gjithë zonën.

Kushte të përshtatshme ka edhe për bujqësi e blegtori, kulturat kryesore janë drithrat e bukës por edhe bimët industriale si duhani, luledielli, panxhar sheqeri etj. pa lënë mënjanë blegtorinë dhe fruta perimet, vresharia etj. që mua më duket e tepërt për të përmendur të gjitha.

Proceset demografike. Në Çezma e vogël kanë jetuar 14 fise; Palla, Baçi, Guçe, Driza, Buçuku, Bako, Qosolli, Merollari, Çipi, Brakolli, Minçe, Llapushi, Tako dhe Lipe, dy rë fundit nuk ekzistojnë më, janë shuar. Prejardhja e tyre është e ndryshme dhe nuk dihet me saktësi por sipas legjendës fiset më të mëdha Baçi, Guçe dhe Driza thuhet se kanë ardhur nga Molla e Kuqe, por, shprehja Molla e Kuqe thuhet edhe për një vend të largët apo mbase është i pa qenë, pra një (Eldorado) që nuk dihet ku ndodhet, por në rastin konkret për këta 3 fise thuhet se kanë ardhur nga

Molla e kuqe e Elbasanit, zona e Zolisit e cila ka qenë një zonë e banuar dhe e qytetëruar dhe mbase në zhvillimin urban të Polisit një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe rruga Egnatia që kalon nëpër Polis. Thuhet gjithashtu nga gojëdhënat se Polisi është sulmuar dy herë nga turqit dhe ka pjesë që ky ka qenë shku i çvendosjes së popullsisë për në jug, në Mokër. Toponimi Polis nga greqishtja e vjetër do të thotë qytetërim ose fillim qytetërimi dhe fakti që është sulmuar dy herë nga turku dëshmojnë se ai ka qenë një qendër urbane e konsoliduar dhe me fillim qytetërimi.


Po kështu edhe për fisin e Pallës legjenda thotë që vjen nga Molla e kuqe si edhe tre të parat, ky është një variant dhe varianti i dytë thotë se: vjen nga Molla e kuqe e Maqedonisë (ky toponim shqip ndodhet në veri të Maqedonisë por unë nuk kam mundësi të saktësoj më tej).

Sipas legjendës fisi Palla në Çezmën e Vogël dhe ai në Çezmën e Madhe kanë ikur nga Molla Kuqe për punë hasmërie dhe janë vendosur në fshatrat e Divjakës, nuk dihet sa rrinë atje dhe vendosen aty ku qenë kanë ardhur në Çezmë me mbiemër Agalliu por më vonë për hir të mbajtjes prej tyre të një lloj arme të kohës së tyre që quhej Pallë edhe këta të ardhur nga Divjaka marin mbiemrin Palla që e kanë edhe sot. fisi Palla ka qenë 68 banorë në 21 familje, në Çezmë tani është vetëm një familje.

Fiset Baçi dhe Guçe të ardhur nga Polisi, legjenda thotë se kanë qenë dy vëllezër, Braçer dhe Agush prej ndarjes së tyre dalin dy mbiemrat – Braçe – Baçi dhe Agush – Guçe edhe këto janë nga familjet e mëdha të fshatit.

Në qershor – korrik të 1915 kur Lufta e Parë Botërore kishte filluar, serbi që kishte ardhur në Mokër që për rastin konkret ishte në Llëngë, nis një togë ushtarë për të djegur Baçin, motivi ishte se në familjen e Baçit ishte strehuar e kish ndenjur frëngu që ish në koalicion me austro-hungarezin të cilët ishin kundërshtarë të serbit, por, mbasi informohen për gjëndjen që po krijohet. Brahim Baçi që kryesonte familjen, mbledh miq, shokë, të afërm e simpatizantë i ze pritë togës serbe dhe e shpartallon, mbas kësaj përplasje serbët e mbetur largohen për të ardhur përsëri.

Pak ditë pas kësaj që ndodhi serbi kapi 9 burra të fisit Palla ku ishin me gjënë e gjallë në pyll, te kroj i Penjës edhe këtu të fshehur nga serbi. Të 9-të burrat pasi u kishin marrë armët që i kishin fshehur të gjithë në një vend, u lidhën me një litar në kohën e pushkatimit tre burra prenë litarin dhe ikën në pyll kurse 6 veta u vranë. – Ali Palla, Myredini, Qemali, Shazhi Mehmet Ripo, midis të pushkatuarve njëri shpëtoj dhe iku mbasi nuk e kishte zënë asnjë plumb. 5 të vranët u varrosën aty ku u vranë në fund të sheshit para se të vesh te kroj i penjës dhe qe prej asaj kohe vendi mori toponimin (varret e Pallës) dhe kështu vazhdon të quhet edhe sot. ■



Librazhdi në rrjedhën e historisë

Nga Zabit CUKU

Në Kandavinë antike bënte pjesë edhe katundi i Librazhdit. Osmanët kur erdhën në shekullin e 15-të pas luftimeve të gjata e të përgjakshme, që të shuanin kryengritjen e udhëhequr nga Gjergj Golemi, ata bënë të parin regjistrim të popullsisë. Osmanët në vitin 1467 kanë regjistruar 38 shtëpi, në një fshat i vogël.

Rruga Egnatia kalonte në brgeun tjetër të Shkumbinit, dhe nuk përmendesh. Fshati filloj të gjallërohet nga fundi i viteve 20-të, në shekullin e 20-të kur filloj të ndërtohet rruga e re Elbasan-Korçë, dhe një degëzim rrugë që lidhe Librazhdin me Dibrën, këtu punimet u kryen me punë angari nga banorët përgjatë rrugës. Nga Mbreti është dhënë urdhëri që secili kryefamiljar duhej të regjistronte një numur të caktuar ditësh në ndërtimin e rrugës në vitin 1929.

Në regjistrimin e vitit 1923, Librazhdi kishte 71 shtëpi. Një vit më vonë këtu u vendos qendra e një nënprefekturë të re që varej nga Elbasani. Në vitin 1945 kishte arritur në 115 shtëpi, ku banonin 899 banorë.

Filloi të zhvillohej që në përdorjen e qeverisjes së Ahmet Zogut, italianët filluan të ndërtonin minerat e hekur-nikelit

ku kjo zonë ka qenë e pasur me sasira të mëdha.

Në qendër të librazhdit u ndërtua një han, disa dyqane, postë-telegrafa dhe ndonjë godinë administrative, pra këto ishin ndërtesat e para të fshatit.

Kafeja e Llaz Popës, është themeluesi i vërtetë i qytetit të ardhshëm të Librazhdit. Në vitin 1958 Librazhdi u shëndrrua në qendrën e një rrethi më vete.

Në vitin 1972 në Librazhd kalon hekurudha në një terren malor Elbasan Përrenjas me drejtimin për në Gurin e Kuq Pogradec. Në këto kushte filloi me gjërësisht shfytëzimi i minierave të këtij rrethi duke rritur me tej aktivitetin ekonomik. Në Librazhd ka patur edhe një garnizon ushtarak, ky i ndërtuar që në kohën e Zogut dhe të Italisë. Kështu në Babje në një rajon shumë të përshtatshëm në kohën e Italisë është ndërtuar si një garnizon ushtarak shumë i rregullt dhe tepër i fortifikuar për interesat e tyre pushtuese dhe për mbështetje në çdo drejtim, ishte një pike lidhse, siguruese dhe mbështetse.

Edhe pas çlirimit të vendit në këtë garnizon u vendosaën forca të Ushtrisë Shqiptare në nivel batalioni. Në vitin 1960 u krijua në nivel Brigade këmbësorie, në vitin 1983 në nivel Divizion këmbësorie, në vitin 1992, kalon në nivel brigade

këmbësorie dhe në vitin 2002 garnizoni ushtarak i Babjes në Librazhd u reduktua.

Në vitin 1930-të në Librazhd kanë qenë ndërtesat e Popajve, Hani i Xhemal Bicit, ato të Mehjes dhe rreth 5-6 shtëpi. Shkolla u hap në vitin 1939.

Në vitin 1967, mori një frymë të gjërë në jetën artistike të rrethit mjeshtri i merituar Sadi Halili, i cili u bë i famshëm me asamblin e valleve të krahins dhe sidomos të Rrajcës. Edhe tani Sadiu pse ka aftësi fizike të kufizuara, prapë punon dhe jep maksimumin për përhapjen dhe gjallërimin e jetës artistike.

Studioja e piktorit Sami Roci afron shumë qytetarë çdo ditë. Ai është arsimuar në Tiranë, familja e tij ka ardhur nga Hotolishi në Librazhd që në vitin 1967.

Historianët e Librazhdit, që janë të shumtë, punojnë për pasqyrimin e historisë lokale. Vlen të përmenden librat Avni Alcani "Librazhdi,, shtëpia botuese "Progres,, viti 2008, Shaban Gjura "Librazhdi dhe Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare,, Tiranë, 2008, e shume e shumë të tjera.

Librazhdi si një nyje lidhëse ka nevojë për një vemendje në fushën e investimeve më të mëdha sidomos në infrastrukturën rrugore dhe një zhvillim të fuqishëm të turizimit malor të cilin është shumë i bukur dhe ndër të veçantët.





Remzi LEKA

REMZI LEKA DO TE MBETET NJE MOKRRAR I NDERUAR

Vitet kalojnë, por puna e të ndjerit Remzi do të mbetet përherë në kujtesën e familjes, të nipërve dhe shokëve të tij. Që në mosh të re, ai u edukua nga një familje atdhetare. Me çlirimin e Shqipërisë ai ndjeu rëndë varfërinë që kishte pllakosur familjen, Mokrën dhe të gjithë Shqipërinë. Me mbarimin e shkollës, Remzi u përkushtua punës për të përmirësuar jetën familjare. Dy ishin problemet më madhore për të ndjerin, të vazhdon të shkollën dhe të punonte për të jetuar. Jetën e tij e shikonte së bashku me fshatarët. Kudo ku u emërua me punë e përgjegjësi shtetërore të asaj kohe, ai në plan të parë ndihmonte ata fshatarë me të ardhura të pakta ekonomike.

Gjithmonë në shpirtin e tij bënte çmos për tu sistemuar në punë. Edhe në sistemin diktatorial kishte korrupsion por ai kurrë nuk u pajtua me këtë njollë të keqe të shoqërisë. I thjeshtë dhe gojë ëmbël jetonte me bashkëfshatarët dhe punëtorët.

Në vizitat shoqërore që ai bënte tek miqtë e shokët kërkonte thjeshtësi dhe çiltërsi. Nuk donte t'i vinte në siklet për pritjet e traditat bujare mokrane. Ishte i prerë dhe i vendosur kundra prirjeve të shumta që rëndonin shëndetin e njerëzve e të ekonomisë familjare.

Gjithmonë kënaqej me këngët mokrane që i këndoheshin luftës për çlirimin e vendit apo dëshmorëve të gjithë Mokrës. Trimave Zallorë që me

trimëri mbrojtën tokat nga pushtuesit e fuqishëm. Ai kënaqej nga tregimet e kushërinjve të tij, Luman Leka e Bari Leka si dhe dajës së tij Hasani. Të gjitha këto e shumë ngjarje të tjera ishin një frymëzim për Remziun. Në kohën e demokracisë, Remzi u ul me banim në Pogradec. Në çastet e jetës kur po plotësonite dokumentat për pension thoshte: Cdo ditë do të dal buzë liqenit të Pogradecit me nipërit dhe mbesat. Familja për Remziun ishte e shtrenjtë. Në këtë dy vjetor kanë lindur nipçe por ti Remzi nuk i sheh. Vdekja tragjike më 29 shtator 2007 preku familjen, miqtë e shokët. Të kujtojmë e përulemi para teje. Ti do mbetesh i paharruar për familjen, miqtë e shokët!

Fatmir BALLIU

(In Memoriam - Guri Tola)

Kur largohet një mik i dashur

Vdekja e shpejtë, tmerrësisht e befte e mikut tonë të dashur, Guri Tola, të gjithë ne shokëve të tij, na trishti skajërisht. Si mund të ikte ashtu Guri, pa lajmëruar, pa thënë asnjë fjalë, asnjë amanet. Pse vendosi të shkojë në atë botë befasisht, si i zemëruar me të gjithë? Prej 16 korrikut të hidhur kur iu shfaq së pari dhimbja e stomakut, nuk kaluan as dy muaj nga largimi përfundimtar në gjumin e pafund. Ne e morëm vesh njëri pas tjetrit lajmin e hidhur.



vrejtur ra telefoni im:

- Istref, Guri na la, u thauj shokëve, përgatit diçka për ta lexuar në varrim.

Ishte LLambi Buzo, kunati i Gurit dhe shoku im i vjetër.

Nuk e kuptova tamam apo vetëdija ime nuk e përceptoi dot atë "Guri na la", nuk e dëgjova pjesën tjetër, kërkesën e thjeshtë e të rëndë, të flisja në varrimin e tij. Menjëherë lajmërova shokët që më ranë

ndërmend. Me zë të dridhur dhe lot në sy u jepja lajmin e rëndë, "Guri na la".

E përcollëm shokun tonë të dashur në varrezat e qytetit atje në gështenjat. Nuk mund ta harroj kurrë atë ditë të vretur vjeshte. Duke sikur vjeshta mbante zi dhe qante me lot prej shiu. Gjethet e zverdhura të gështenjave na preknin lehtë butësisht. Donin të na jepnin kurajë të mbanim lotët, të mpaknim dhimbjen që buronte te të gjithë.

Kur arkivoli po rrëshqiste në gropën e zezë u dëgjua kuja e dhimbshme e të bijave:

- O babi mos ik!

Mes lotëve të vajzave, Marjetës, djalit, nënës kërcure, të afërmëve të shumtë dhe miqve të pafund nisi Guri Tola jetën tjetër të amëshuar.

Zooteknika i talentuar, i cilësuar nga ekspertët si specialist blegtorie nga më të mirët e rrethit të Pogradecit, tani nuk jeton më. Ne, shokët e tij e kujtojmë shpesh, sa herë vjen rasti kudo kur mblidhemi tok.

- Guri Tola ishte i rrallë, i ndershëm përtej të zakonshmes, i mirë në thelbin e tij njerëzor. I kishte shokët e rrallë, - thotë Feim Jasharllari, ndër miqtë më të afërt të tij.

Feimi i pashëm, burrëror nuk e fshih trishtimin. Vështrimi tretur diku kërkon profilin e shokut të tij, që nuk rron më.

- Nuk e prish dot numërin e celularit të Gurit, - thotë sypërlotur, - më duket se po t'i bie do të përgjigjet.

Dhori Vako, ndër shokët e tij të afërt thotë i menduar dhe i prekur:

- Ishte ndër njerëzit e veçantë me një korrektësi të admirueshme, skrupuloz në punë dhe i përkushtuar. Te Guri të gjithë shihnin njeriun e pnës, i drejtë dhe besnik në marrëdhënie me njerëzit.

Mokrari i mençur, portreti i tij i ëmbël, fjala e menduar dhe e ngrohtë duket sikur e kanë sfiduar vdekjen, e cila nuk ka mundur ta largojë Gurin tonë të dashur në gjumin e pacak. Ai vazhdon të jetë mes nesh shokëve të tij, në gjirin e familjes model, shpirti i tij endet përreth, na përkëdhel butësisht me dorë të padukshme prej ajri dhe ne bëhemi më të ndjeshëm, më të mirë...

Nuk munda t'i them këto fjalë në varrim, ndaj e ndjeva detyrë t'i shkruaj për të gjithë miqtë dhe të afërmit e tij të shumtë. Dua t'u them të gjithëve se njerëz si Guri Tola jetojnë gjatë në kujtesën e atyre që e njohën.

Istref HAXHILLARI

65 VJETORI I ÇLIRIMIT TË ATDHEUT (1944-2009)

NAUN LLËNGA, LUFTËTARI TRIM I MOKRËS SË SIPËRME QË RA DËSHMOR PËR ÇLIRIMIN E TIRANËS

Nga LLAZI TONA

Në moshë të vogël dole malit për liri pushka jote krisi në jugë e veri që nga Korça plakë gjer në Peshkopi Naun te Ura e Farkës se çzure pusi dhe vrave gjermanë, aq sa deshe ti plumbi i mallkuar të rroku në sy gjithë Brigada e katërt për ty mbajti zi

Naumi lindi në vitin 1926 në Llëngë të Mokrës në një familje me ndjenja atdhetdashëse. Gjyshi i tij Spiro mori pjesë në Luftën për pamvarësinë e vendit i inkuadruar në çetën e patriotit Pun Kokoneshi këto ndjenja u trashëguan dhe te i ati i tij Ndini, i cili pushtimin fashist e priti me urrejtje të madhe. Në vitin 1942 ai familjarisht u lidh me udhëheqësin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Mokrës akademikun Reshit Çollakun. Shtëpia Ndinit ka qenë e hapur për udhëheqjen e Levizjes, për militantët por dhe i ka mbrojtur ata në ato raste kur ka qenë në rrezik.

Ndini së bashku me vëllezërit u aktivizuan që në fillim me Njësitin Gueril të Llëngës që komandohej At. Dhimitër Kokoneshi dhe kanë marrë pjesë në shumë aksione si në Vëlçan, Osnoms, Guri i Kamjes etj.

-Jeta nuk ka kuptim për lirinë e atdheut, që vjen i huaj e bëhet zot i vendit, të merr erzin, nderin, lirinë. Kjo nuk durohet. Këto ishin disa fjalë që u tha Naumi njerëzve të shtëpisë, në ato ditë kur ngjeshi gjerdanin dhe hodhi malierin krahash e doli partizan së bashku me shaxhanë Kristo.

-Zakoni e do, or bir - i tha i ati duke e puthur në ballë, të uroj të dalësh faqebardhë... Shëndoshë dhe me Lirinë të kthehesh.

Kështu u nda ai me familjen.

Tetëmbëdhjetë vjeç, ishte Naumi kur e nisi Epopenë partizane. Mori pjesë në çetën partizane të Mokrës, Batalionin e Mokrës e më vonë në Batalionin e Dytë të Brigadës së Katërt Sulmuese. Atje ai u bë shpejt një luftëtar i zjarrtë dhe i vendosur për çlirimin e vendit. Atje ai u kalit dhe fitoi cilësi e veti të reja të një luftëtarit të vërtetë. E mbi të gjitha atij iu shtua urrejtja për armikun nuk përmbahej me sulmet. E qortonin, shpesh shokët që të mos qëllonte në këmbë.

-Keni të drejtë - u thoshte ai - veten duhet ta ruajmë; armikun ta godasim, ta vrasim. Po i shihni? Nuk durohen. Shikoni sa gjermanë u grumbulluan atje! Nuk të vjen të shkosh e t'i shuash të tërë me nje bombë?

Kështu luftonte vazhdimisht. Ai qëllonte pa pushim e agresojë mbi armikun.

Kush nuk e njohte Naun Llëngën me Batalionin e Dytë të Brigadës së Katërt Sulmuese, për guximin, shkathtësinë, trimërinë dhe sjelljen e tij me shokët në luftën me armikun.

Me shumë beteja të zhvilluara si në Qafën e Thanës, Guri i Kamjes, Kamenicë, Zeflan,

në Bone e Çermenikës, Peshkopi, Lurë, Mirditë, Labinot e deri në Luftën për Çlirimin e Tiranës spikati trimëria dhe guximi i këtij partizani. Naun Llënga në këto luftime ishte gjithmonë në ballë të aksioneve i pamëshirshëm me armikun.

-Lemizhdë po më duken megjithatë janë të armatosur mirë - thoshte ai - gjaku mu ndez tani. Kam hak për të marrë.

Në luftimet për çlirimin e Peshkopisë kompania e parë e Batalionit të Dytë i ishte caktuar detyra që të sulmohej armiku nga krahu i djathtë. Lufta filloi ashpër. Lufta mori përmasa të mëdha. Partizanët me pushkë e bomba dore u hodhën me sulm të furishëm mbi armikun. Kudo dëgjoheshin breshëritë e zjarrit të armëve partizane, dëgjohesh dhe zëri i Naun Llëngës. Automatiku i tij vinte zjarr të pandërprerë mbi forcat armike. Në këto beteja ai fitoi admirimin dhe respektin e shokëve pa guximin dhe trimërinë e rrallë.

Në Luftën për Çlirimin e Tiranës Naun Llënga i jepet titulli oficer dhe i caktohet detyra komandant toge të cilën e kreu me nder ashtu siç i ka hije një partizani deri në fund të jetës së tij.

Në këto luftime u dallua në shumë aksione që ndërmorën partizanët në drejtim të Pallatit të Brigadave, Qyteti i nxënësve, Tiranës së Re etj.

Gjermanët duke qenë nën trysinë e forcave partizane ishin struktur brenda në qytet dhe nuk guxonin të dilnin nga qyteti por prisnin ndihmë nga forcat që ndodheshin në Jug.

Kompania që ndodhesh në afërsi të Urës së Farkës kishte marrë urdhër nga Shtabi i Batalionit që të godiste gjermanët që ishin në poste për ruajtjen e Urës. Për të kryer këtë detyrë ju ngarkua Naunit me efektivin e togës së tij. Aksioni ishte mjaft i vështirë për ta kryer, por Naumi me zgjuarsinë që e karakterizonte gjeti variante për ta kryer këtë aksion të rëndësishëm.

Ishte 4 Nëntori i vitit 1944. Rrezet e diellit shndrrisnin sikur të ishte pranverë. Degët e pemëve binin lehtë për tokë. Naun Llënga bashkë me partizanët ju afrua shtëpisë që ishte afër Urës dhe futen brenda shtëpisë që ishte ballë për ballë me postën e gjermanëve.

Nga kjo shtëpi filloi të vërshojë furishëm automatiku i Naunit. Me breshërinë e parë vret katër gjermanët dhe plagos disa. Ky ka qenë një aksion i shpejtë dhe i befasueshëm mbi armikun që i përjetoi për disa minuta. Por një i plagosur rëndë qëllon mbi luftëtarin dhe komandantin e togës Naun Llënga, i cili qëllonte mbi armikun pa lëshuar armën nga dora deri në sekondën e fundit të jetës së Tij duke frymëzuar me trimëri shokët e tij. Kështu pushoi së rrahuri zemra e zjarrtë e burrit të Mokrës së Sipërme, dëshmorit të LANÇ Naun Ndini Llënga.

Populli i Tiranës i ka ngritur një përmendore afër varrezave të Dëshmorëve të Tiranës. Ndërsa Komuna e Mokrës së Sipërme i dha titullin "KRENARIA E MOKRËS".

JETA GJASHTËMUJORE E GJERASIM D. QIRIAZIT ME KAÇAKËT



Nga Zenun FERO

Historia e Shoqërisë Biblike në Shqipëri

Gjerasim Qiriazit, ka përshkruar jetën e cubave, bisedat e tyre dhe të gjitha ato që i kanë ndodhur nga 12 nëntor 1884 deri 25 prill 1885, gjashtë muaj sa ka qënë peng u tyre. Dorëshkrimin e la në gjuhën shqipe, por nuk është gjetur, prandaj libri është bërë nga përkthimi i tij nga anglishtja.

Libri "Pengu i Kaçakëve,, i Gjerasim D. Qiriazit është përkthyer në gjuhën angleze nga J. W. Berdi, u botua në Londër në vitin 1902, nga Religionus Tract, Society. Libri u botua për herë të parë në gjuhën shqipe në prag të 100 vjetorit së vdekjes së Gjerasim Qiriazit, nga shtëpia botuese "Kartë e Pende,, në vitin 1993.

Shoqëria Biblike u formua në Angli në vitin 1804, me qëndër në Londër, me qëllim që të realizonte përkthimin, shypjen dhe shpërndarjen e Fjalës së Perëndisë, në mbarë botën. Për Shqipërinë ajo filloj të interesohet më 25 gusht 1816, dhe pas vizitës që bëri Dr. Aleksandër Tomsonit skocez, për tetë ditë në Tiranë, Elbasan Berat. Atij i rekomanduan një shqiptar, që të përkthente librat në Shqip, që kishte studioar në Maltë dhe ndodhej në Tunizi, Konstandin Kristoforidhi.

Më 7 Janar 1865 Kristoforidhi, i shpreh kënaqësinë e tij, Shoqërisë Biblike, që më në fund vendosi të bëjë diçka për Shqipërinë. Më 31 gusht 1870 Kristoforidhi u kthye në Shqipëri në shtetërim të Shoqërisë Biblike për të shitur librin të cilët ai ishte munduar aq shumë t'i përkthente. Më 1882, Dr. Aleksandër Tomsoni dëgjoi për një shqiptar të ri nga Manastiri, i cili sapo kishte mbaruar studimet teologjike në Somokv të Bullgarisë. Më 18 Janar 1883 i shkruan, për të punuar pranë Shoqërisë Biblike. Gjerasim Qiriazit e pranoi bashkë me libër shpërndarjen e Gjon Ciku.

Në pranverën e vitit 1884, Gjerasimi kthehet në Manastir, dhe krijon një bazë, nga e cila do të përhapte punën e Shoqërisë Biblike në Shqipëri. Ai filloi të jepte mësim shqip për nxënësit e shkollës amerikane në Manastir, kurse natën mësonte të rriturit. Në shkollën e hapur në Korçë më 7 mars 1887, janë përdorur botime të shoqërisë Biblike.

Shoqëria Biblike, me botimet, shitjen dhe shpërndarjen e literaturës shqipe nëpër të gjithë vendin, përkrahu dhe ndihmoi fuqimisht luftën kundër alfabetizimit në Shqipëri. Në vitet e para të Luftës Parë Botërore janë marrë me punët e Shoqërisë Biblike dhe Gjergj Qirazi, Nuçi Naçi, Gligor Cilka, Anastas Sina e tjerë. Dr. Aleksandër Tomsoni (Skocez) si përfaqësues i shoqërisë Biblike, njihet nga rilindasit më të njohur, duke përfshirë Naim Frashërin, Jani Vreton, Petro Nini Luarasain, Pandeli Sotirin, Thimi Mitkon e të tjerë.



JETA ME KAÇAKËT

Më 12 nëntor 1884 Gjerasim Qiriazit u nis nga Manastiri për në Korçë. Tek Qafa e Zvezdës, në grykën e Lajthizës, kaçakët, me kapëdanin e tyre Shahin Matraku e marrin peng, dhe i kërkuar që t'i sillnin pesëqind lira, më 13 nëntor 1884. Kaçakët që e morën peng ishin Shahin Matraku, nga Popçishti, Lefter Nuri nga Bozhigradi, të dy kapëdanë, Kajo Babjeni kapëdan i një grupi 10-15 vetash, e shumë të tjerë. Nga Mokra, Llënga ishin Tun Kokoneshi, Rapi Kokoneshi me tre vëllezër), Narti, Laskë Kokoneshi (i biri i Tahirit), Ban Kokoneshi (14 vjeç) nga Lahja, i biri i Nartit, Veseli, Hyseni. Këta dy të fundit u ndanë nga të tjerët në kohën kur më zunë peng, por gjatë rrugës për në shtëpi i kapën e i shpunë në burgun e Manastirit, kur më zunë mua, ishin vetëm njëzet e dy vetë, por më vonë u shtuan edhe të tjerë. (Gjerasim D. Qiriazit "Pengu i Kaçakëve "Shtëpia botuese "Kartë e Pendë" vitin 1993, faqe 35-36)

Shahin Matraku hallet e kishin bërë kaçak, kishte vajtur në Opar, kishte një grup kaçakësh, kishte një vullë, dhe ishte kaçak që nga viti 1875. Kaçakët kaluan Maliqin, shkuan në Shipkë, në Krushevë, në fshatin Osoje, në Ganukas, Popçishti, Kucak, në kasollet e Lozhanit, në Strelcë, tek Shpella e Lugëve, tek Sharrat e Grabovës, më 8 prill 1885.

Tek Sharrat e Grabovës, filloi biseda me kapëdan Shahin Matraku. Ai i dha një letër që i vinte nga shtëpia. Kur e lexoi Gjerasimit i rrodhën lot, mori vesh se të gjithë në shtëpi i kishte mirë. Shahini shkoi në Grabovë, ndërsa kaçakët qëndruan tek sharrat në një kasolle. Ish-te nata e parë që Gjerasimi kuvendoi lirisht pranë zjarrit, kishte për jastik një kërciu të mirë druri dhe atë natë bëri një gjumë mjaft të rehatshëm. Kishte katër muaj që nuk shtrihet në dërrasa atë dimër,

por vetëm nëpër gurë, dëborë, e tokë.

Në mëngjes, Shahin Matraku i jep një copë byrek, e bukë gruri. Të nesërmen u nisën drejt Llëngës, me Tun Kokoneshin që i printe, ishin 28 kaçakë. Në dorëshkrimin e Gjerasim Qiriazit shkruhet "Dy shkëmbinj të mëdhenj nga dhjetë metra të lartë, që dukeshin si mure përkarshi njëri-tjetrit kishin vënë në mes një hapësirë të vogël, si kështjellë, u ngritën kasollet.. Pastaj premë degë bredhi, e ngritëm kasollet. Ngritëm dy të mëdha për të gjithë. Tun Kokoneshi me ca të tjerë ngritën edhe një tjetër te skaji i Kresh-tës. Buka na vinte nga shtëpia e Kokoneshëve në Llëngë. Nga një herë disa kaçakë venin në fshatrat për qark për të marrë bukë, sepse një shtëpi s'mund të mbante dot me bukë njëzet e tetë frymë sa ishim ne,, (faqe 126-127).

Shahin Matraku, Kajo Babjeni, e Tun Kokoneshi ishin kapëdanët që drejtonin kaçakët në çdo drejtim.

NGJARJET NË LLËNGË, MOKËR.

Më 28 prill 1885, në shtëpinë e Kokoneshëve kishte ardhur dikush me pare për lirim të Gjerasim Qiriazit. U mblodhën Shahin Matraku, Kajo Babjeni, Nuriu, dhe i premtuan se do ta lironin.

U përshëndet me kaçakët, dhe në mëngjes u nis i lirë, i printe Shahini. Në rrugë takuam Nikolla Zarçë, i cili kishte sjellë paratë e shpërblimit, me një djalë që quhej Man. Shumica e kaçakëve ngulën këmbë që të lirohej Gjerasimi. Tërë atë ditë e kaluam duke kënduar e duke qëlluar në shenjë me pushkë martine.

Para se të ikte, Shahin Matraku, i dhuroi një lirë, që ta kishte me vete Gjerasimi. Tun Kokoneshi dhe Lokja nga Skrapari shoqëruan Gjerasimin. Të pestë, Tun, Lokja, Zarçja, Mani dhe Gjerasimi morën rrugën, ndërsa Shahini u kthye me të tjerët. Kaluam nëpër Mokër dhe arritëm në

fshatin Lin në breg të liqenit të Ohrit. Aty deri në Ohër kaluam me lundrim me varkë. Për të marrë Gjerasimin, kishin ardhur në Lin vëllai i tij Kosta dhe Gjon Ciku. I zoti i stanit në Lin i priti mirë atë natë, në mëngjes u nisëm drejt Ohrit.

Në Ohër shkua në shtëpinë e Zarçës, aty Gjerasimit i dhanë një palë rroba të reja. Ato të vjetrat i futi në hebetë e kalit dhe i shpuri në Manastir. Atë natë atë se merrte gjumi, dhe në të gëdhirë mori udhën për në Manastir. (Gjerasim Qiriazit "Pengu i Kaçakëve,, faqe 145)

DISA KAPEDANË E KAÇAKË NË MOKËR E VËRÇË.

Kapëdan Jaçe Jolla, i pari i fisit Jolla, drejtonte Poraçanin. Ai mbrojtë fshatin nga turqit, nga tërë burrat e fisit të tij mbeti gjallë vetëm ai. (Istref Haxhillari "Bari Ujku" shtëpia botuese Toena,, Tiranë 2009 faqe 213). Fisi u largua, Shën Mërena i priti, emrin e vendit i'a vunë Jollë. I pari i Shën Marenës,, udha tokë, i bëri bujq të Manastirit.

Kaçaku Kapo Mato, rrinte në malet e Lenies, bashkë me grupin e tij. Kapua ishte nga fshati Rashtan, Vërçë, dhe aktiviteti i tyre ishte edhe në Mokër. Ushqimin e siguronin nëpër fshata merrnin bagëti të imta e i grumbullonin në Lenie. Tregon Asllan Fero (gusht 2006) se një herë kishin marrë bagëti me forcë në fshatin Homçan, dhe banorët i ndoqën deri te ura e Slabinjës. Një herë tjetër morën bagëti te stani i Rapçës, por banorët e Velçanit i rrethuan, e i lanë bagëtite.

Arif Biba tregon, (Korrik 2009), se kaçaku Kapo Mato kishte në grup edhe Tele Masati, nga fshati Kukër, Xhile Qyrkun, Kukër. Ishin të armatosur dhe shkonin deri në Strugë, dhe lëviznin natën. Turqit, kishin vajtur në fshatin Rashtan, e kishin arrestuar, dhe do e dënonin. Por me shpejtësi u lajmëruan banorët e fshatrave për rreth, dhe erdhën e rrethuan turqit, dhe këtë të fundit e liron. Kapo Mato, nuk i vrau turqit, u mori armët, u'a uli me kokë poshtë, i shoqëroi deri në Mokër, ku i la të lirë të shkonin në Strugë. Kjo u bëri pështrypje të gjithë Vërçës, Mokrës e dëgjua deri në Pogradec, Ohër, Opar, Gorë. Tregojnë, se një ngjarje kishte tronditur rëndë.

Në Mal të Thatë, kishte lidhur një çoban pas një druri dhe i kishte marrë tufën e bagëtive. Por kur u kthye pas një viti, tek druri, gjeti eshtrat e çobanit, dhe pas kësaj nuk bënte më të tilla veprime.

Në jetën prej kaçaku, vrau gabimisht djalin e tij. Jeta familjare i ka shkuar jo mirë, u martua tre herë, dhe gruaja është ndarë nga jeta në vitin 1962.

Miqësia e tij në Mokër vazhdon në disa fshata, si në Velçan, me fisin Lufo, në Slabinjë me fisin Balliu e tjerë, por kishte edhe hasmëri, në Çezmën e Vogël, në Velçan, Homçan e tjerë: Dëgjonte shumë, në Rashtan, Hajdar Mato, dhe Lufot në Velçan, ata i kishte miq. Sipas burimeve gojore, Kapo Mato është ndarë nga jeta rreth viteve 1930-të, la një familje të madhe me djem e vajza. Natyrisht ai ishte i fuqishëm, trim por ka pasur edhe anë negative, që vepronte i nxituar herë pas here.

Kaçakët nuk u konsideruan si keqbërës në cepat e historisë. Përkundrazi në çdo etapë, u futën në komunitet të ndryshme dhe bënë pjesë aktive. Me zgjerimin e Romës në Perandori, dhe në lindje pati një zhvillim të fuqishëm të inkursioneve në tokë të tipit piratesk dhe Pompeu i madh u ngarkua nga Senati në vitin 67 para krishtit, ta luftonte.

GJURMË TË LASHTESISË

KOMUNIKACIONI TOKËSOR SHQIPTAR, NGA LIDHJA E PRIZRENIT DERI NË SHPALLJEN E PAVARËSISË (1878-1912)



Nga Llaz TONA

(Vijon nga numuri i mëparshëm)

Burimet arkivore hedhin dritë mbi kontribut që kanë dhënë mjetet e transportit për Ushtrinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për të plotësuar nevojat e saj me armë, ushqime dhe veshmbathje në sasi dhe kohën e caktuar. Bie në sy fakti që vitet e stuhishme të Lidhjes kanë nxjerë urdhëresa që shprehin interesimin për organizimin e transportit ushtarak këshillave për trofetë e luftës, Lidhja u ngarkoi detyra të veçanta për regjistrimin dhe ndarjen e kafshëve që do t'ju merrnin si plaçkë lufte armikut.

Dokumentet e Lidhjes shqiptare tregojnë shumë mbi shërbimin e transportit ushtarak për mbrojtjen e tërësisë së kufijve të veriut dhe të jugut. Në mënyrë të veçantë del në pah përdorimi i kafshëve që populli shqiptar dha për mbrojtjen e Plavës dhe Gucisë. Nga dokumentet del se atëherë çdo ditë niseshin nga Shkodra për në Tuz 60-100 kuaj me miell, përveç materialeve ushtarake e veshmbathje për forcat vullnetare. Me qindra kuaj të ngarkuara me armë dhe ushqime dërgoheshin nga krahina të ndryshme të vendit në drejtim të Veriut. Karvani i parë përshkoi nga Shkodra me një karvan prej 60 kuaj të ngarkuar me materiale lufte. Një karvan nisej nga Peja me treqin qase me miell, 200 martina, fishekë. Po kësh-tu dhe nga krahina të tjera.

Më 1902 në vendin tonë u ndërtua rruga për lëvizje me anën e kafshëve dhe qerreve. Kjo rrugë fillonte nga Manastiri – Korçë – Janinë me një gjatësi 200 kilometra Inxhinjeri Italian që merrej me caktimin dhe matjen e rrugëve shpërblehej (30 qindarka ari ose flori) për kilometër. Gjithsej mori 2600 napolona ari. Punësimin e rrugës, si gjërmime, çeljen e kanaleve dhe thyerjeve, shtrimin e çakullin e



Shqiptare ne fillm te viteve '900

bëri popullsia e vendit me punë angarije.

Më 1894 Kosova mbante lidhje me Selanikun sidomos për ndërtimin e hekurudhave. Kështu më 1894 u ndërtua hekurudha Manastir-Selanik. Më 1896 u ndërtua hekurudha Selanik-Stamboll.

Në vitet e para të shekullit XX-të me hekurudhën Selanik-Mitrovicë u eksportuan 4000 ton produkte bujqësore e tjera.

Ndërsa tabela e qarkullimit të mallrave dhe udhëtimit sipas stacioneve dukej kështu (shih tabelen poshte). Nga gjithë sasia e grurit në Vilajetin e Kosovës eksportohej më se 3/4 e tyre kjo për në Selanik.

Më 1902 u fillua ndërtimi nga të dy anët i rrugës nga manastiri-Elbasan. Po shumë pak u bë sepse ju dha rëndësi ndërtimit Manastir-Ohër si dhe pjesa e rrugës Elbasan-Fusha e Shushicës – Fusha Bullit – Polis rrugë këto për karvanxhinjtë.

Më 1908-1909 u ndërtua pjesa e rrugës prej Qukësi në Hotolisht. Punimet u bënë nga një kompani ushtarësh turq të dënuar për arsye se kishin marrë pjesë në një kryengritje. Në

ndërtimin e kësaj rruge morën pjesë dhe banorë të zonave përkatëse jo vetëm që pagonin taksat por dhe punë angari.

Me krijimin e Qeverisë shqiptare më 1912 pra me fitoren e Pamvarësisë së Shqipërisë populli shqiptar nuk trashëgoi nga sundimi otoman asnjë rrugë automobilistike veçse 100 km rrugë që mund të tërhiqeshin mjetet me anën e kafshëve (karroca apo qerre).

Pak e dinë dhe shumë nuk e dinë se nga fundi i shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX Prof. Antonio Baldaci Akademik i Shkencave të Bolonjës, të Bukureshtit të Budapestit, të Anthina ndërmori një varg studimesh të thella dhe shumë të dobishme me një sinqeritet të madh dhe një përvojë udhëtimesh nëpër Shqipëri (25 vjet). Udhëtime dhe kërkime nëpër Shqipëri. Ai bëri vizitë dhe në qytetin e Pogradecit dhe kreu studime e kërkime shkencore në Niçe e Llëngë.

“Komuna e Llëngës – shkruan ai në Libër – ka pasur 7000-8000 shtëpi. Niça 6000-7000 shtëpi aq dhe Grabova ndërsa sot deri në 100 shtëpi. Në to ai bën studime dhe kërkime shkencore në mënyrë të veçantë në pyjet e stërmadhura të Llëngës si në Kurrorën e Valmarës, Gurë, Gur-Top, në Lenie të Niçes, në pyje të Grabovës dhe në disa pyje të tjera të Shqipërisë.

Rëndësi ai i kushtoi dhe gjallesave të tjera si Flora dhe Fauna pra kafshëve të egra dhe bimëve mjekësore që rriten në pyll.

Ai zbuloi 200.000 mijë bimësh që ndodheshin nëpër pyjet e Shqipërisë dhe i dërgon ato nëpër muzetë e Evropës si Romë, Paris, Berlin, Vjenë, Moskë, Londër etj. Një pjesë e konsiderueshme e tyre akademiku Antonia Baldaci i zbuloi në kurrorën e Valmarës së Llëngës dhe në pyjet e Niçes. Mjaft nga këto bimë morën emrin “Baldaç”. Çdo udhëtim që ai bëri në këto zona shoqërohej dhe mbrohej nga çeta e Kokoneshëve.

Kokoneshët – shkruan ai në Librin e tij – janë një familje e madhe antike. Ata janë Kokon pra janë nga fisi Dukë, fis mbretëror. Kanë banuar midis Vlorës dhe Kavajës në Shën premtja. I madhi i

tyre ka qenë kryekapo të çetave deri në Janinë. Një vit pas vdekjes së tij udhëheq djali i madh Thanasi”. (Shih librin).

Akademiku Antonia Baldaci botoi disa libra për Shqipërinë si “Intenerari Albania”; “Studia Albanesi” etj. si dhe mbi njëqind shkrime nëpër gazeta dhe revista të asaj kohe si: “Çështja shqiptare”; “Shteti i ri shqiptar”; “Mbi pyjet e Shqipërisë”; “Ripyllëzimi i Sazanit”; “Të rimëkëmbim Ilirinë”; “Burimet e Florës dhe Faunës”, në Shqipëri”; “Shqipëria monografi”; “Gjendja minere në Shqipëri” etj.

Në këtë shkrim do të përqendrohëm pak për “komunikacionet në Shqipëri” sipas Librit “Rrugëtime Shqiptare” (1892-1902) të autorit Akademik pr-ANTONI BALDACI.

“Komunikacionet janë sot tepër të pamjaftueshme në Shqipëri dhe mandej as që ekzistojnë në kuptimin modern dhe civil, në Shqipëri mungojnë thuajse krejtësisht rrugët për makina dhe karroca në kuptimin e saktë të kësaj fjale. Është fare e vërtetë se mund të kalojnë mjete transporti ndërmjet Mjedës dhe Shkodrës, ndërmjet Durrësit dhe Tiranës dhe ndërmjet Beratit, Fierit dhe Vlorës (pa pjesët shkatërruese, ndoshta janë më shumë se 150 km. rrugë karrocash të ndërtuara në kohën e Turqisë) por edhe këto rrugë kanë nevojë të rindreqen.

Kanë mbetur vetëm rrugët e karr-aneve të shumta në disa pjesë me kall-drëme sipas traditës romake të ndërtuar nga pushtuesit e mëparshëm.

Kjo mungesë rrugësh, që natyrisht e ka vështirësuar qëndrimin, ka penguar përparimin politik dhe social si dhe ekonominë e lirë të të dy ndarjeve të mëdha të popullit për njohjen e ndërsjellë: Gegët e Toskët sot janë të ndarë nga ndryshimet, fetare, katolike dhe islamike në Veri, ortodokse dhe islame në Jug me përqindje më të mëdha të myslimanëve në qendër domethënë rajonin më të madh të zonës si dhe i të ardhmes të Shqipërisë.

Që Shqipëria të zhvillohet është e detyrueshme të ndërtohen këto rrugë:

1. Rruga Shkodër-Elbasan, nëpërmjet Mjedës, Lezhës, Krujës, Tiranës dhe më tepër në Berat dhe drejt Vlorës.
2. Nga Durrësi në Vardarin e Shkupit nëpërmjet Tiranës dhe Dibrës. Kjo rrugë do të thithë produktet e Serbisë.
3. Nga Durrësi në Manastir, nëpërmjet Elbasanit e Ohrit për të transportuar produktet e Maqedonisë.
4. Nga Mjeda në Prishtinë dhe në Danub rrugë që ka për qëllim të ndihmojë Shkodrën e cila për ndryshe do të shuhet.

5. Nga Saranda në Gjirokastrë me degëzimet për të lidhur këto qendra kryesore të Epirit dhe për të lidhur këto me arteriet e sipërshënuara.

6. Një rrugë që duhet të jetë paralele me Detin e Zi për në Dibër e deri në Ohër”.

Këto ishin devizat e Akademikut Antonio Baldaci për komunikacionin tokësor shqiptar.

Qeveria provizore e Vlorës dhe Princi Vidi në Durrës nuk ju përmbajtën këtij studimi të veçantë për komunikacionin tokësor shqiptar. Pra ato nuk bënë gjë. Ndikuan dhe ngatërsat shqiptare dhe ato të jashtme, që penguan pothuajse çdo veprim në këtë fushë. Ato ndërtuan vetëm një rrugë për qerre nga Tirana në Durrës.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Tiranë, më 20.10.2009

Stacioni	Qarkullimi i udhëtarëve	Qarkullimi i mallrave	Ardhje Shkuarje	Shkarkim -ngarkim
Shkup	16482	17810	9254	36922 ton
Mitrovicë	3452	3496	3045	6533

